

REPUBLIKA E SHQIPËRISË | PROFILI I DYTË 2023

TREGUESIT E  
QEVERISJES SË  
MIGRACIONIT



IOM-i është i angazhuar ndaj parimit që migracioni njerëzor dhe i rregullt i sjell përfitime migrantëve dhe shoqërisë. Si organizatë ndërqeveritare, IOM-i bashkëvepron me partnerët e vet në komunitetin ndërkombëtar: për të dhënë asistencë në përmbushjen e sfidave operative të migracionit; për të nxitur botëkuptimin në lidhje me aspektet e migracionit; për të nxitur zhvillimin ekonomik-shoqëror përmes migracionit; dhe për të mbajtur lart dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë detyrimisht ato të Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM). Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit gjatë gjithë dokumentit nuk nënkupton shprehjen e opinionit të IOM-it në lidhje me statusin juridik të çdo vendi, qyteti, zone apo autoriteteve të tyre, apo kufijve përkatës.

---

Me gjithë përpjekjet që janë bërë për të verifikuar saktësinë e këtij informacioni, as Economist Impact dhe as bashkëpunëtorët e tij nuk mund të pranojnë asnjë përgjegjësi nga askush që bazohet në këtë informacion.

Botues: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin  
17 route des Morillons  
P.O. Box 17  
1211 Gjenevë 19  
Zvicër  
Tel.: +41.22.717 91 11  
Fax: +41.22.798 61 50  
Email: [hq@iom.int](mailto:hq@iom.int)  
Internet: [www.iom.int](http://www.iom.int)

Me studim dhe analizë nga

**ECONOMIST  
IMPACT**

Citim i kërkuar: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), 2023. *Treguesit e Qeverisjes së Migracionit Profili i dytë 2023 – Republika e Shqipërisë*. IOM, Gjenevë.

---

ISBN 978-92-9268-695-6 (PDF)

© IOM 2023



Disa të drejta janë të rezervuara. Ky punim bëhet i disponueshëm sipas [Creative Commons Attribution-NonCommercial-NoDerivs 3.0 IGO License](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/legalcode) (CC BY-NC-ND 3.0 IGO).\*

Për saktësime të mëtejshme lutemi shikoni të drejtat e [autorit dhe kushtet e përdorimit](#).

Ky publikim nuk duhet të përdoret, botohet apo rishpërndahet për qëllime të synuara kryesisht apo të orientuara drejt përfitimit tregtar apo shpërbllimit monetar, me përjashtim të qëllimeve arsimore, p.sh. të përfshihet në tekstet shkollore.

Lejet: Kërkesat për përdorim tregtar apo të drejta dhe licensime të tjera duhet të paraqiten në [publications@iom.int](mailto:publications@iom.int).

\* <https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/legalcode>

REPUBLIKA E SHQIPËRISË | PROFILI I DYTË 2023

# TREGUESIT E QEVERISJES SË MIGRACIONIT



## PASQYRA E LËNDËS

OBJEKTIVAT // 6

**HYRJE // 7**

KUADRI KONCEPTUAL // 9

**PËRDITËSIME // 11**

**KONTEKSTI // 14**

**GJETJET KRYESORE // 17**

PAS VLERËSIMIT TË MGI-SË // 32

**BURIMET KRYESORE // 33**

**ANEKS // 37**

## OBJEKTIVAT

Treguesit e Qeverisjes së Migracionit synojnë të ndihmojnë qeveritë, sipas kërkesës, të hartojnë inventarë të politikave e strategjive të tyre migratore për të identifikuar praktikatat e mira dhe fushat me mundësi të mëtejshme zhvillimi.

Treguesit e Qeverisjes së Migracionit krijojnë mundësinë për dialog me qeveritë dhe aktorët e tjerë përkatës për të identifikuar përparësitë si dhe për të përcaktuar rrugën përpara. Duke qenë të përqendruar te pronësia e qeverisë mbi procesin, Treguesit e Qeverisjes së Migracionit ofrojnë mbështetje për të përmirësuar gradualisht sistemet e menaxhimit të migracionit në nivelin kombëtar dhe vendor.



HYRJE

“ Migracioni ka qenë pjesë e përvojës njerëzore përgjatë historisë dhe ne, në botën tonë të globalizuar, e njohim atë si burim mirëqenieje, novacioni dhe zhvillimi të qëndrueshëm dhe këto efekte pozitive mund të optimizohen duke përmirësuar qeverisjen e migracionit.<sup>1</sup>

Nevoja për të rritur në maksimum mundësitë që sjell lëvizshmëria dhe për t'u përballur me sfidat e saj është pranuar si e tillë me përfshirjen e migracionit në Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe me miratimin e Paktit Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt. Përfshirja e objektivit 10.7 në Agjendën 2030 krijoi nevojën për të përkufizuar “politikën e planifikuara dhe të mirë menaxhuara të migracionit”. Për këtë arsye, në vitin 2015, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) hartoi Kuadrin e Qeverisjes së Migracionit<sup>2</sup> (MiGOF). Ky Kuadër<sup>3</sup> ofron një këndvështrim konciz për një qasje ideale që e lejon shtetin të përcaktojë atë për të cilën ai mund të ketë nevojë për të qeverisur mirë migracionin dhe në një mënyrë që u përshtatet rrethanave të tij. Në të njëjtin vit, IOM-i në bashkëpunim me *Economist Impact*, hartoi Treguesit e Qeverisjes së Migracionit (MGI), një grup standardesh prej thujse 100 treguesish që ndihmojnë shtetet të vlerësojnë sa të gjithanshme janë strukturat e tyre të qeverisjes së migracionit.

Treguesit përbëjnë një pikënisje për përfshirjen e qeverive në një proces konsultimi që u jep mundësi atyre të identifikojnë fushat e zhvilluara mirë dhe të tjera që do të përfitonin nga zhvillimi i mëtejshëm dhe, çfarë është më e rëndësishmja, të përcaktojnë përparësitë që përkojnë me sfidat dhe mundësitë konkrete me të cilat përballet një vend i caktuar.

MGI-të kanë tri karakteristika kryesore themelore:

1. Procesi MGI-ve është një ushtrim **vullnetar**: MGI-të zhvillohen në ato vende që kanë kërkuar të jenë pjesë e procesit.
2. MGI-të janë **të ndjeshme ndaj specifikave kombëtare**: MGI-të njohin sfidat dhe mundësitë e secilit kontekst dhe, për rrjedhojë, nuk propozojnë një zgjidhje për gjithçka, por synojnë të nxitin diskutime lidhur me atë çfarë nënkupton migracioni i mirë qeverisur.
3. MGI-të shtrihen përgjatë një **procesi**: Procesi i MGI-ve nuk është një instrument statik për të mbledhur të dhëna rreth kornizave të migracionit të vendeve. Përkundrazi, ai është hapi i parë i një ushtrimi dinamik që mund t'i lejojë qeveritë të identifikojnë fushat e politikës së tyre të migracionit që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm, ose që mund të përfitojnë nga ndërtimi i kapaciteteve.

MGI-të pranojnë se të gjitha vendet kanë realitete, sfida dhe mundësi të ndryshme lidhur me migracionin. Për rrjedhojë, MGI-të nuk renditin vendet sa i takon formulimit ose zbatimit të politikave të tyre migratore.

Së fundi, MGI-të nuk matin rezultatet apo efektivitetin institucional të politikave të migracionit. Përkundrazi, ato bëjnë një vlerësim të politikave migratore në fuqi dhe veprojnë si kuadër standard që ofron këndvështrime mbi masat e politikave që mund të shqyrtojnë vendet ndërsa ecin përpara drejt mirëqeverisjes së migracionit.

Vlerësimet vijuese të MGI-ve tregojnë përparimin që kanë bërë vendet në politikën e tyre të qeverisjes së migracionit që prej vlerësimit të parë të MGI-së.<sup>4</sup> Ky profil për vendin paraqet një përmbledhje të ndryshimeve dhe arritjeve kryesore të ndodhura në strukturat e qeverisjes së migracionit në Republikën e Shqipërisë (në vijim referuar si Shqipëria), që nga viti 2018, si dhe fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm, sipas vlerësimit të MGI-së.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Kombet e Bashkuara, *Pakti Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt* (A/RES/73/195, datë 11 janar 2019), paragrafi 8.

<sup>2</sup> “Qeverisja e migracionit” i referohet sistemit të institucioneve, kornizave ligjore, mekanizmave dhe praktikave që synojnë të rregullojnë migracionin dhe të mbrojnë migrantët. Përdoret thujse si sinonim i termit “menaxhimi i migracionit”, edhe pse ky i fundit përdoret ndonjëherë për t'u referuar ligjit specifik mbi rregullimin e lëvizjes ndërkufitare në nivel shtetëror.

<sup>3</sup> Këshilli i IOM-it, *Kuadri i Qeverisjes së Migracionit*, Sesioni i 106-të, C/106/40 (4 nëntor 2015), faqja 1, shënimi në fund të faqes 1.

<sup>4</sup> Profili i Qeverisjes së Migracionit për Republikën e Shqipërisë është i disponueshëm këtu.

<sup>5</sup> Nisma e MGI-së është një program standardi politikash i drejtuar nga IOM-i dhe i zbatuar me mbështetjen e *Economist Impact* dhe financohet t nga shtetet anëtare të IOM-it.



# KUADRI KONCEPTUAL

## MiGOF

MiGOF-i i IOM-it përcakton elementet themelore për mbështetjen e migracionit të planifikuar dhe të mirë menaxhuar. Ai synon të paraqesë në mënyrë të konsoliduar, koherente dhe gjithëpërfshirëse një grup prej tri parimesh dhe tri objektivash, të cilat, nëse respektohen dhe përmbushen, do të garantojnë që migracioni të jetë njerëzor, i organizuar dhe në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë.

### PARIMET

1. **Respekton** standardet ndërkombëtare dhe përmbush të drejtat e migrantëve.
2. **Formulon** politika duke përdorur të dhëna dhe një qasje “mbarëqeveritare”.
3. **Angazhohet** me partnerët për zgjidhjen e çështjeve të migracionit dhe atyre të lidhura me të.


### OBJEKTIVAT


1. **Rrit** mirëqenien social ekonomike të migrantëve dhe të shoqërisë.
2. **Trajton efektivisht** përmasat e lëvizshmërisë gjatë krizave.
3. **Garanton** që migracioni të zhvillohet në mënyrë të sigurt, të organizuar dhe dinjitoze.


Në  
themel

## MGI-të


### ÇFARË JANË

 Një grup treguesish që ofrojnë këndvështrime të thelluara mbi instrumentet nxitëse të politikave që mund të përdorin vendet për të forcuar strukturën e tyre të qeverisjes së migracionit


 Një instrument që identifikon praktikat e mira dhe fushat që mund të zhvillohen më tej

 Një proces konsultimi që çon përpara dialogun mbi qeverisjen e migracionit, duke sqaruar se çfarë pamje mund të ketë “migracioni i mirë qeverisur” në kontekstin e synimit 10.7 të OZhQ-së dhe zbatimit të Paktit Global për Migracionin\*

### ÇFARË NUK JANË

 Nuk janë renditje e vendeve

 Nuk janë vlerësim i ndikimeve të politikave

 Nuk janë normative

Që mbështet  
matjen e



*Shënim:* “Pakti Global është hartuar në përputhje me synimin 10.7 të Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, ku shtetet anëtare angazhohen të bashkëpunojnë në nivel ndërkombëtar për të lehtësuar migracionin e sigurt, të organizuar dhe të rregullt.” Më shumë informacion është në dispozicion këtu.

MGI-të përbëhen nga thujse 100 tregues të grupuar në gjashtë dimensione të ndryshme të qeverisjes së migracionit, që mbështeten te kategoritë e Kuadrit të Qeverisjes së Migracionit (KQM):



TË DREJTAT E  
MIGRANTËVE  
FAQE 18

Treguesit në këtë sferë shohin nivelin e aksesit të migrantëve në shërbime të caktuara sociale, të tilla si shëndetësia, arsimi dhe sigurimet shoqërore. Po ashtu, ato përqendrohen te ribashkimi familjar, aksesit në tregun e punës dhe mundësia e qëndrimit dhe e nënshtetësisë. Këtu përfshihen gjithashtu dhe konventat ndërkombëtare të nënshkruara dhe të ratifikuara.



QASJA  
MBARËQEVERITARE  
FAQE 21

Treguesit në këtë fushë vlerësojnë kornizat institucionale, ligjore dhe rregullatore të vendeve të lidhura me politikën e migracionit. Kjo fushë shqyrton edhe praninë e strategjive kombëtare të migracionit që janë në përputhje me objektivat e zhvillimit dhe përpjekjet për zhvillim jashtë vendit, si dhe me transparencën dhe koherencën institucionale në lidhje me menaxhimin e migracionit.



PARTNERITETET  
FAQE 24

Kjo kategori përqendrohet te përpjekjet e vendeve për të bashkëpunuar me shtete të tjera dhe aktorët përkatës joqeveritarë mbi çështjet që lidhen me migracionin, përfshi organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat.



MIRËQENIA E  
MIGRANTËVE  
FAQE 26

Treguesit në këtë fushë vlerësojnë politikën e vendit për njohjen e kualifikimeve arsimore dhe profesionale të migrantëve, dispozitat që rregullojnë migracionin e studentëve dhe ekzistencën e marrëveshjeve dypalëshe të punës. Këtu përfshihen dhe aspekte të angazhimit të diasporës në vendin e origjinës dhe dërgesat e migrantëve.



DIMENSIONI I  
LËVIZSHMËRISË I KRIZAVE  
FAQE 28

Kjo kategori trajton llojin dhe nivelin e gatishmërisë së vendeve kur ato përballen me dimensionet e lëvizshmërisë së krizave. Pyetjet qëmtojnë proceset ekzistuese për shtetasit dhe joshtetasit lidhur me katastrofat dhe ndryshimin e klimës, përfshi edhe nëse ndihma humanitare u vihet njësoj në dispozicion si migrantëve ashtu edhe shtetasve.



MIGRACIONI I SIGURT,  
I ORGANIZUAR DHE I  
RREGULLT  
FAQE 30

Kjo fushë shqyrton qasjen e vendeve ndaj menaxhimit të migracionit sa i takon kontrollit të kufirit dhe politikave zbatuese, kritereve të pranimit për migrantët, gatishmërisë dhe rezistencës, në rast fluksesh migratore të mëdha dhe të papritura, si dhe luftës kundër trafikimit të personave.



PËRDITËSIME

## PËRDITËSIME QË NGA VITI 2018

### Të drejtat e migrantëve

Që nga vlerësimi i mëparshëm, Ligji i ri “Për Shtetësinë” (2020) ka shtuar mënyrat e përfutimit të shtetësisë shqiptare, duke u lejuar migrantëve të martuar me shtetas shqiptarë të aplikojnë për nënshtetësi pas tre viteve martesë dhe pasi kanë jetuar për të paktën një vit në Shqipëri. Migrantët që janë prindër të një të mituri me shtetësi shqiptare kanë po ashtu mundësi të aplikojnë për nënshtetësinë shqiptare pasi kanë jetuar ligjërisht dhe vazhdimisht për të paktën tre vjet në Shqipëri. Personat pa shtetësi dhe refugjatët mund të aplikojnë gjithashtu për nënshtetësi nëse kanë jetuar për të paktën shtatë vjet në Shqipëri.

Personat me qëndrim afatgjatë dhe familjet e tyre kanë mundësinë për të punuar në kushte të barabarta me shtetasit në Republikën e Shqipërisë. Që nga vlerësimi i mëparshëm i MGI-së në vitin 2018, Ligji i ri Nr. 79, “Për të huajt” (2021), përfshiu një “leje unike” për të gjithë imigrantët e tjerë për mundësi punësimi.

Në vitin 2019, Shqipëria miratoi Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e saj të Veprimit 2019–2022, që trajton diskriminimin kundër migrantëve. Strategjia konstaton nevojën për më shumë trajnim për gjyqtarët dhe forcat e policisë, si dhe një monitorim më të mirë të zbatimit të të drejtave të migrantëve. Plani i Veprimit përfshin masa mbi rritjen e ndërgjegjësimit të migrantëve për të drejtat e tyre dhe plotësimin e tyre efektiv, si dhe monitorim më të mirë të rasteve të diskriminimit kundër tyre.

### Qasja mbarëqeveritare

Që prej vlerësimit të mëparshëm të MGI-së, Shqipëria ka forcuar legjislacionin kombëtar mbi migracionin, duke rregulluar imigracionin përmes Ligjit Nr. 79, “Për të huajt” (2021), i cili trajton regjimet e hyrjes, qëndrimit, punës, studimit dhe daljes për migrantët në Shqipëri, duke përcaktuar regjimet dhe procedurat e vizave dhe lejeve, si dhe përmes Ligjit Nr. 10, “Për azilin” (2021), i cili trajton procedurat për dhënien e azilit dhe mbrojtjes së përkohshme dhe plotësuese dhe rrit nivelin e bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse.

Strategjia Kombëtare për Migracionin e vitit 2019 dhe Plani i saj i Veprimit 2019–2022, synojnë të ndërtojnë një qasje ndërsektoriale për migracionin për të rritur në maksimum përfitimet e migracionit për migrantët dhe shoqërinë shqiptare. Strategjia është në përputhje me përparësitë e tjera kombëtare, të tilla si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016–2020, Strategjia Kombëtare për Diasporën (2018–2024) dhe realizimi i Agjendës 2030.

Strategjia Kombëtare për Migracionin e vitit 2019 dhe Plani i saj i Veprimit 2019–2022, ngritën mekanizma monitorimi dhe bashkërendimi për zbatimin e strategjisë, përkatesisht Sekretariatit Teknik për Migracionin në Sektorin për Emigracionin të Ministrisë së Brendshme, Komitetin Teknik për Migracionin, dhe Grupin Drejtues për Migracionin.

Në vitin 2020, Shqipëria miratoi Strategjinë Kombëtare për Diasporën 2021–2025 dhe në vitin 2022, kompetencat e Ministrisë së Shtetit për Diasporën lidhur me angazhimin e diasporës iu caktuan Agjencisë Kombëtare për Diasporën dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

### Partneritetet

Në shkurt të vitit 2019, Shqipëria miratoi, mes 40 vendeve të tjera, Angazhimet e Stambollit për Partneritetin e Rrugës së Mëndafshit për Migracionin dhe Planin e Veprimit.

Qeveria shqiptare ka forcuar partneritetet e saj me diasporën përmes krijimit të Këshillit Koordinues të Mësuesve në Diasporë në vitin 2020 dhe Këshillit Koordinues të Diasporës në vitin 2018.

Shqipëria ka shtuar memorandumet e mirëkuptimit (MM) të nënshkruara me vendet e destinacionit duke nënshkruar Marrëveshjen e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së

Madhe dhe Irlandës së Veriut në vitin 2021 dhe Memorandumin e Mirëkuptimit midis Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Migracioni në vitin 2022.

Në vitin 2019, Shqipëria u bë pjesë e nismës Ballkani i Hapur, një marrëveshje rajonale që nxit lëvizshmërinë e forcës së punës. Si rezultat, Shqipëria ka nënshkruar disa MM dhe marrëveshje mbi turizmin, administrimin tatimor, import-eksportin e mallrave, aksesin e lirë në tregjet e punës dhe ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

## Mirëqenia e migrantëve

Duke filluar nga viti 2019, procesi i aplikimit për njohjen e diplomave të huaja kryhet tërësisht online përmes portalit qeveritar elektronik “e-Albania”.<sup>6</sup>

Në vitin 2021, Shqipëria miratoi Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030 për të nxitur barazinë gjinore për të gjitha gratë, përfshi ato migrante, në forcën e punës, duke rritur aksesin e tyre në “punën e denjë”.

Ligji Nr. 79, “Për të huajt” (2021), ka forcuar kuadrin institucional të vendit, për të garantuar rekrutimin etik të migrantëve, duke i ngarkuar Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (APKA) përgjegjësinë për kryerjen e vlerësimeve të të gjitha proceseve të rekrutimit brenda dy javëve nga marrja e kërkesës për leje pune. Përveç kësaj, sipas ligjit, APKA-ja mund të refuzojë miratimin e kërkesës për punësimin e migrantëve, nëse “punësimi është bërë pas një vendosjeje ose rekrutimi të parregullt”.

## Dimensioni i lëvizshmërisë i krizave

Në vitin 2019, qeveria miratoi Ligjin Nr. 45, “Për mbrojtjen civile”, për të ulur rrezikun nga katastrofat dhe për të garantuar mbrojtjen e njerëzve përmes forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Neni 57 parashikon shprehimisht se “çdo subjekt, vendas apo i huaj, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje nga strukturat e mbrojtjes civile, në rast katastrofash”.

Në vitin 2021 u përditësua Plani i Kontingjencës për një Fluks të Madh të Mundshëm Migrantësh dhe Azilkërkuesish në kufirin shqiptar për të garantuar të drejtat e migrantëve dhe azilkërkuesve në Shqipëri, duke përmirësuar kapacitetet e identifikimit, përpunimit dhe ofrimit të shërbimeve për migrantët dhe azilkërkuesit përmes krijimit të një mjedisi ku migrantët ndihen të sigurt.

Sipas Ligjit të ri Nr. 10, “Për azilin” (2021), Shqipëria iu ofron mbrojtje të përkohshme personave që largohen nga lufta ose kriza të ngjashme dhune apo konflikti në vendet e tyre, të cilat nuk mund të garantojnë mbrojtjen e tyre.

## Migracioni i sigurt, i organizuar dhe i rregullt

Në vitin 2020 Ministria e Brendshme miratoi Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022 (2020), për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Ky i fundit u referohet konkretisht migrantëve dhe parashikon trajnim të përsëritur për oficerët e policisë së kufirit dhe migracionit.

Që prej vlerësimit të mëparshëm të MGI-së, Shqipëria ka forcuar procedurat e saj për të identifikuar dhe ndihmuar në kohë migrantët në situata në rrezik duke krijuar leje qëndrimi të përkohshme të “tipit A” me afat tremujor për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit, në përputhje me Ligjin Nr. 79, “Për të huajt” (2021).

Ligji Nr. 10, “Për azilin”, i vitit 2021, forcon qasjen e procedurave dhe masave që kanë në qendër fëmijën, që synojnë të garantojnë mbrojtje për fëmijët migrantë, përfshi fëmijët e pashoqëruar.

<sup>6</sup> Ai ndodhet këtu.




KONTEKSTI

Gjatë dy dekadave të fundit, imigracioni në Shqipëri ka pësuar rënie, pas arritjes së pikut të tij në vitin 2000 (76,695 persona).<sup>7</sup> Shifrat e Departamentit të Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale (DESA) tregojnë se, deri në mes të vitit 2020, në vend jetonin 48,8 mijë migrantë ndërkombëtarë, që përfaqësojnë 1,7% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Të dhënat e ndara sipas gjinisë tregojnë se përqindja e femrave emigrante në vitin 2020 (49%) ishte pak më e ulët sesa përqindja e meshkujve (shih Figurën 1). Përveç kësaj, Figura 2 tregon se shumica e imigrantëve në vitin 2020 ishin 0-19 vjeç, të pasuar nga migrantët në moshë pune, të cilët përbënin 40% të imigracionit gjithsej.

Nga ana tjetër, Shqipëria ka përjetuar emigracion në rritje që prej viteve 1990, me shifra emigrimi që arritën 1,2 milionë vetë në vitin 2020, më shumë se një e treta e popullsisë së saj të përgjithshme (2,9 milion). Sipas të dhënave të vlerësuara nga DESA,<sup>8</sup> 49% e tyre ishin femra dhe 51% meshkuj (shih Figurën 1). Krahasimi i shifrave të imigracionit me emigracionin tregon se migracioni i përlogaritur neto në Shqipëri për vitin 2022 shkante në -10,6 mijë migrantë. Përveç kësaj, të dhënat nga Banka Botërore tregojnë se dërgesat personale të marra në Shqipëri në vitin 2022 përbënin 9,9% të PBB-së.<sup>9</sup>

**Figura 1.** Migracioni ndërkombëtar nga dhe drejt Shqipërisë (në mes të vitit 2020), sipas gjinisë




Burimi: DESA, 2020. Stoku Ndërkombëtar i Migrantëve 2020.

<sup>7</sup> Portali i të dhënave të migracionit. E vendosur këtu.

<sup>8</sup> Ibid.

<sup>9</sup> Ibid.

**Figura 2.** Migrantët sipas grupmoshave në vitin 2020

Burimi: DESA, 2020 në Portalin e të dhënave të migracionit.





GJETJET

KRYESORE



## 1

## RESPEKTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE PLOTËSIMI I TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE

### 1.1. Qeverisja e migracionit: shembuj të fushave të zhvilluara mirë

Sipas vlerësimit të mëparshëm të MGI-së, migrantët, në varësi të statusit të migracionit, mund të kenë akses në shërbimet shëndetësore të financuara nga shteti, ashtu si edhe shqiptarët. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e strategjive në sektorin e kujdesit shëndetësor, si dhe për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Personat ekonomikisht aktivë me qëndrim të përhershëm trajtohen njësoj si qytetarët shqiptarë që janë ekonomikisht aktivë, çfarë nënkupton se ata kanë sigurimin e detyrueshëm shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore njësoj si qytetarët shqiptarë, në përputhje me Ligjin Nr. 10 383, “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor” (2011).<sup>10</sup> Në rast urgjence mjekësore, në rastet kur mungesa e kujdesit shëndetësor përbën rrezik për jetën, të gjithë migrantët, pavarësisht statusit të tyre ligjor, mund të marrin kujdes shëndetësor, në përputhje me Ligjin Nr. 10 107, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (2009) dhe Ligjin Nr. 79/2021, “Për të huajt” (2021).

Shqipëria u jep mundësi arsimimi të gjithë migrantëve, pavarësisht statusit të migrimit, azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave me mbrojtje plotësuese. E drejta për arsimim është e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (1998) dhe, në nenin 46 të Ligjit Nr. 79, “Për të huajt” (2021). Më tej, Ligji Nr. 69, “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” garanton të drejtën e arsimimit “të qytetarëve shqiptarë, të huajve dhe personave pa shtetësi pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, etnie, gjuhe, orientimi seksual, bindjeje politike dhe besimi fetar, situatë ekonomike ose shoqërore, moshe, vendqëndrimi, aftësie të kufizuar apo për arsye të tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar”. Sipas të njëjtit ligj, arsimi ofrohet falas për të gjithë nxënësit nga niveli parashkollor<sup>11</sup> deri në arsimin e mesëm. Përveç kësaj, Ligji Nr. 10, “Për azilin” (2021) u garanton personave me statusin e refugjatit dhe atyre që gëzojnë mbrojtje plotësuese të drejtën e arsimit parauniversitar dhe universitar njësoj si qytetarëve shqiptarë dhe shtrihet më tej te e drejta për arsimim e fëmijëve që aplikojnë për azil. Për të zbatuar këto dispozita, zyrat vendore të arsimit të Ministrisë së Arsimit kanë hartuar plane të posaçme për përgatitjen e azilkërkuesve dhe fëmijëve të pashoqëruar për shkollë dhe për të mbështetur integrimin e tyre, edhe përmes ofrimit të kurseve të gjuhës. Këto shërbime vendore i ndihmojnë gjithashtu fëmijët e të kthyerve të ndjekin mësimet në shkollat lokale. Ato monitorojnë dhe raportojnë dy herë në vit mbi ecurinë e tyre tek zyrat rajonale të arsimit.

Të gjithë migrantët e rregullt kanë të drejtën të marrin shërbimet e mbrojtjes sociale në Republikën e Shqipërisë. Ligji Nr. 7703, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (1993) parashikon shprehimisht se përfitojnë sigurime shoqërore “qytetarët shqiptarë dhe personat pa shtetësi, ish-shtetasit shqiptarë, ata që janë jashtë vendit, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që punojnë në Shqipëri”. Sigurimet shoqërore ofrojnë një sërë përfitimesh në rast “paaftësie të përkohshme në punë, për shkak të sëmundjes, shtatzënisë, moshës së vjetër, aftësisë së kufizuar dhe humbjes së personit që mban familjen, aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, papunësisë” (neni 7 i Ligjit Nr. 121, “Për mbrojtjen sociale” (2016)). Neni 8 garanton të drejtën për mbrojtjen sociale, konkretisht, shërbime në qendrat komunitare, përfshi qendrat për zhvillim; shërbime në qendrat rezidenciale; shërbime sociale në situatat e emergjencës; shërbime të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror dhe shërbime të specializuara, për “të huajt, personat pa shtetësi dhe refugjatët, të cilët jetojnë në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>10</sup> Sigurimi shëndetësor mbulon vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit parësor shëndetësor dhe në spitalet publike; vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në objektet private të kujdesit shëndetësor parësor dhe në spitalet private; mjekimet, produktet dhe trajtimet shëndetësore nga shërbimet shëndetësore të kontraktuara.

<sup>11</sup> Sipas Ligjit Nr. 69/2012, arsimi parashkollor vlen për fëmijët midis moshës tre dhe gjashtë-vjeçare.

Shqipëria ka disa marrëveshje me vende të tjera lidhur me transferimin e përfitimeve të sigurimeve shoqërore. Në vitin 2003, Shqipëria ratifikoi Marrëveshjen midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për Sigurimet Shoqërore, e cila parashikon pagesën e përfitimeve të sigurimeve shoqërore për shqiptarët që jetojnë në Turqi dhe anasjelltas. Në vitin 2015 hynë në fuqi Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore mes Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Republikës së Shqipërisë, Marrëveshja midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, si dhe Marrëveshja me Republikën e Hungarisë për Sigurimet Shoqërore, të cilat garantuan transferimin e sigurimeve shoqërore ndërmjet këtyre vendeve. Në vitin 2016 hyri në fuqi Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore midis Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës së Shqipërisë, e cila iu dha mundësi shqiptarëve që jetojnë në Belgjikë dhe anasjelltas të marrin përfitimet e sigurimeve shoqërore nga vendi i tyre i origjinës. Në të njëjtin vit, u nënshkrua Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore me Republikën Federale të Gjermanisë (2016), Marrëveshja midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, si dhe me Rumaninë (2016). Njëkohësisht, më 1 korrik 2022, u ratifikua dhe hyri në fuqi marrëveshja që siguron transferimin e përfitimeve të sigurimeve shoqërore midis Shqipërisë dhe Kosovës.<sup>12</sup>

Personat me qëndrim të përhershëm dhe familjet e tyre kanë mundësi të barabarta punësimi si shtetasit në Republikën e Shqipërisë, kurse të gjithë migrantët e tjerë duhet të kenë leje që të mund të punësohen. Ligji Nr. 79, “Për të huajt”, i lejon personat me qëndrim afatgjatë “të gëzojnë të njëjtat të drejta ekonomike, shëndetësore dhe sociale si shtetasit shqiptarë dhe të punësohen, të vetëpunësohen ose të angazhohen në veprimtari të drejtpërdrejtë biznesi, pa pasur nevojë të pajisen me leje pune” (neni 96). Anëtarët e familjes së migrantëve me qëndrim në Shqipëri nuk kanë nevojë për miratim nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për t’u punësuar në Shqipëri. Sipas ligjit të ri për të huajt, të gjitha llojet e tjera të migrantëve kërkojnë “leje të unifikuar” për t’u punësuar.<sup>13</sup> Sipas Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), lejet e unifikuara mbeten të vlefshme për sa kohë që motivi i dhënies së lejes mbetet i pandryshuar. Do të thotë se imigrantët sipas kësaj leje, në parim, mund të kërkojnë një punë tjetër sipas të njëjtës leje, por ata duhet të njoftojnë autoritetet për ndryshimin në vendin e punës (dhe adresën nëse është e aplikueshme).

Ligji Nr. 113 “Për shtetësinë” (2020) zgjeroi mënyrat e marrjes së shtetësisë, duke lejuar migrantët e martuar me shtetas shqiptarë të aplikojnë për shtetësi pas tre vjetësh martese dhe pas të paktën një viti jetese në Shqipëri. Migrantët të cilët janë prindër të një të mituri me shtetësi shqiptare kanë po ashtu mundësi të aplikojnë për shtetësi pas jetesës së vazhdueshme për të paktën tre vjet në Shqipëri. Edhe personat pa shtetësi dhe refugjatët mund të aplikojnë për nënshtetësi nëse kanë jetuar në Shqipëri për të paktën shtatë vjet.

Shqipëria grumbullon dhe mban statistika mbi shtetasit e saj që jetojnë jashtë. Ministria e Brendshme lehtëson sistematikisht regjistrimin e qytetarëve shqiptarë me qëndrim jashtë vendit përmes Programit të Regjistrimit të Adresës, si pjesë e Regjistrimit të Gjendjes Civile, një proces që nisi në vitin 2016. Kjo bëhet mbi baza vullnetare dhe vetëdeklarimi: qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë mund të regjistrojnë elektronikisht adresën e tyre falas përmes portalit qeveritar, “e-Albania”.<sup>14</sup> Për më tepër, që nga vlerësimi i mëparshëm i vitit 2020, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë miratoi Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021–2025, e cila e ngarkon Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrin e Shtetit për Diasporën me “vlerësimin dhe zgjerimin e Regjistrimit Kombëtar Civil dhe të bazës së të dhënave për migracionin”. Strategjia Kombëtare e Diasporës ngarkon po ashtu Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Ministrinë e Kulturës dhe Ministrin e Shtetit për Diasporën të krijojnë një regjister të veçantë për “identifikimin e shoqatave kulturore, sportive, arsimore, shoqërore dhe shkencore që veprojnë në vendet pritëse, si dhe individët e talentuar dhe të suksesshëm që punojnë në diasporë”.

<sup>12</sup> Referimet ndaj Kosovës do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999).

<sup>13</sup> Këto leje të unifikuara përfshijnë: lejen si punonjës; leje për punësim sezonal; leje për transferime brenda kompanisë; leje si punonjës ndërkufitar; leje për trajnim profesional; leje për praktikuesit e sportit; leje për shërbime vullnetare; leje për punonjësit me kualifikime të larta; leje për personat e vetëpunësuar; leje për punëtorët dixhitalë të lëvizshëm; leje për investitorët; dhe leje për shërbime kontraktuale – kërkohet një kontratë para aplikimit.

<sup>14</sup> Ai ndodhet këtu.

Qeveria shqiptare jep të dhëna për qytetarët që jetojnë jashtë edhe në Profilin e saj të Zgjeruar të Migracionit, i cili botohet çdo katër vjet dhe është botuar për herë të fundit për periudhën 2015–2018.<sup>15,16</sup>

Janë miratuar disa strategji dhe politika për të luftuar krimet e urrejtjes, dhunës, ksenofobisë dhe diskriminimit kundër migrantëve. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) u përditësua në vitin 2022, duke sanksionuar të drejta të barabarta midis migrantëve dhe qytetarëve shqiptarë dhe duke përcaktuar se “të drejtat dhe liritë themelore dhe detyrimet e parashikuara nga Kushtetuta për qytetarët shqiptarë vlejnë edhe për të huajt dhe personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë” (neni 16). Si pjesë e objektivit strategjik të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019–2022 (2019) për “të siguruar një kuadër gjithëpërfshirës kundër diskriminimit që mbron efektivisht të drejtat e migrantëve”, përfshin aktivitete të tilla si “zgjerimi i garancive ligjore kundër diskriminimit”, “rritja e ndërgjegjësimit të migrantëve për të drejtat e tyre dhe si zbatohen ato” dhe “përmirësimi i efektivitetit dhe monitorimit të mekanizmave të mbrojtjes”. Ligji Nr. 10 221, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (2010) përcaktoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi si organin përgjegjës për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi për migrantët. Ligji u ndryshua në vitin 2020 për ta shtrirë “parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit” te “të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”, përfshi “personat e huaj fizikë dhe juridikë”.

## 1.2. Fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm

Në Shqipëri, hyrja e migrantëve në tregun e punës rregullohet nëpërmjet kuotave vjetore. AKPA-ja mbikëqyr përcaktimin e kuotave vjetore për profesionet në Republikën e Shqipërisë dhe u jep miratim kompanive dhe organizmave që kërkojnë të punësojnë migrantë, pasi të kenë vërtetuar se pozicioni nuk mund të mbushet nga kategoritë në vijim: shtetasit shqiptarë të papunë; migrantët e martuar me shtetas/e shqiptar/e; anëtarë i familjes së një migranti me qëndrim në Shqipëri; shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe vendet e Ballkanit Perëndimor me qëndrim në Shqipëri.

Sipas Ligjit të ri Nr. 79, “Për të huajt”, migrantët pa dokumente të vlefshme udhëtimi, një vizë të vlefshme apo leje qëndrimi “nuk marrin shërbime publike nga organizatat dhe administratat lokale, entet me interes publik dhe institucionet e sigurimeve shoqërore” (neni 133). Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila është në varësi të Ministrisë së të Brendshme, mbikëqyr lëshimin e dokumenteve personale, përfshi certifikatat familjare, certifikatat e lindjes, certifikatat e martesës dhe certifikatat e vdekjes. Individët mund të aplikojnë për këto shërbime online përmes portalit qeveritar “e-Albania”,<sup>17</sup> por ato janë të vlefshme vetëm në gjuhën shqipe, edhe pse vetë dokumentet mund të lëshohen edhe në gjuhë të tjera.

<sup>15</sup> Të dhënat e grumbulluara përfshijnë të dhënat e papërpunuara për stokun migrator të vendit, numrin e shtetasve shqiptarë me qëndrim në Bashkimin Evropian (BE), statistika për largimin/dëbimin e shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së, numrin e të miturve të pashoqëruar jashtë, numrin e nënshqetësive të marra në vendin pritës dhe të dhëna për të kthyerit në Shqipëri.

<sup>16</sup> Ai ndodhet këtu.

<sup>17</sup> Ai ndodhet këtu.



## 2

## FORMULON POLITIKA DUKE PËRDORUR TË DHËNA DHE QASJEN MBARËQEVERITARE

### 2.1. Qeverisja e migracionit: shembuj të fushave të zhvilluara mirë

Imigracioni në Shqipëri trajtohet nga Ligji i ri Nr. 79, “Për të huajt” (2021), i cili rregullon regjimet e hyrjes, qëndrimit, punësimit, studimit dhe daljes së migrantëve në Shqipëri, duke përcaktuar regjimet e procedurat e vizave dhe lejeve. Ligji përqendrohet te procedurat e punës, si dhe te të drejtat dhe merr parasysh personat në nevojë, përfshi viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të dhunës gjinore. Njëkohësisht, Ligji i ri Nr. 10, “Për azilin” (2021) trajton procedurat e dhënies së azilit dhe mbrojtjes plotësuese dhe të përkohshme, si dhe rrit nivelin e bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse. Për më tepër, po shqyrtohet mundësia e hartimit të një ligji të ri “Për migracionin”, i cili do të zëvendësojë Ligjin Nr. 9668, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” (2006).

Sekretariati Teknik shqiptar për Migracionin, pjesë e Ministrisë së Brendshme, është përgjegjës për bashkërendimin e hartimit dhe të zbatimit të politikave të migracionit në vend. I krijuar në vitin 2020, Sekretariati Teknik për Migracionin merr raportime çdo tre muaj nga të gjitha ministrinë dhe institucionet e linjës për statusin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit 2019–2022.

Mekanizmi kombëtar koordinues ndërinstitucional i Shqipërisë për çështjet e migracionit përfshin Grupin Drejtues për Migracionin, Sekretariatit Teknik për Migracionin dhe Komitetin Teknik për Migracionin. Grupi Drejtues, i cili u krijua në vitin 2021, është një organizëm këshillimor përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e ecurisë së përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit 2019–2022 dhe përmirësimin e mekanizmave bashkërenduese për të siguruar zbatimin e saj. Grupi Drejtues mbledhet të paktën njëherë në vit dhe herën e fundit është mbledhur më 20 dhjetor 2022. Ai kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe përbëhet nga zëvendësministra të ministrive të ndryshme përgjegjëse për masat e renditura në Planin e Veprimit.<sup>18</sup> Paralelisht, në vitin 2020, Strategjia Kombëtare për Migracionin krijoi Komitetin Teknik për Migracionin, i cili është mbledhur tri herë deri në dhjetor 2022<sup>19</sup> dhe përfshin institucione shtesë për t’u bashkërenduar lidhur me çështjet e migracionit.<sup>20</sup> Sekretariati Teknik për Migracionin i paraqet këtij komiteti raporte tremujore mbi statusin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit 2019–2022.

Shqipëria ka një sërë organizmash që bashkërendojnë aktivitetet e lidhura me diasporën nën varësinë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku funksionon Drejtoria për Diasporën, që prej riorganizimit të QSh-së pas zgjedhjeve të fundit parlamentare në prill të vitit 2021. Sipas Ligjit Nr. 16, “Për Diasporën” (2018), Agjencia Kombëtare për Diasporën është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave mbi diasporën dhe për zbatimin e politikave dhe projekteve përkatëse. Përveç kësaj, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është e ngarkuar të mbrojë dhe të promovojë interesat e diasporës dhe të organizojë aktivitete dhe takime të rregullta këshillimore me anëtarët e saj. Për më tepër, në vitin 2017, u krijua Komiteti Shtetëror për Diasporën me qëllim, ndër të tjera, përgatitjen e udhëzimeve për hartimin e politikave të reja për diasporën; për të propozuar mekanizma ligjore dhe institucionale për çështje që lidhen me diasporën dhe

<sup>18</sup> Ato janë Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës, ish-ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin.

<sup>19</sup> Komiteti Teknik është mbledhur tri herë, më 11 maj 2021, 6 dhjetor 2021 dhe 13 dhjetor 2022.

<sup>20</sup> Këtu përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Instituti i Statistikave (INSTAT), Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti për Mbikëqyrjen Financiare, Avokati i Popullit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Agjencia e Ofritit të Shërbimeve të Integruara Publike, Komiteti Shtetëror për Diasporën, Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë dhe kryetarët e tri bashkive që përfaqësojnë Shoqatën shqiptare të Bashkive.

për të nxitur dhe zhvilluar dialogun për zbatimin e strategjive, ligjeve dhe politikave për diasporën.<sup>21</sup> Përveç kësaj, mbështetur në nenin 2 të Ligjit Nr. 32/2018, në vitin 2018 u krijua Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për të siguruar “ofrimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare, në kuadrin e promovimit të zhvillimit social ekonomik dhe kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për diasporën përmes nxitjes dhe inkurajimit të përpjekjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj”.

Që prej vlerësimit të mëparshëm të MGI-së, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit 2019–2022 (2019), të hartuara nga Grupi Ndërinstitucional i Punës,<sup>22</sup> nën bashkërendimin e Ministrisë së Brendshme, me mbështetjen e IOM-it. Strategjia synon të ndërtojë një qasje ndërsektoriale për migracionin, me qëllim që të rrisë në maksimum përfitimet e migracionit për migrantët dhe shoqërinë. Ajo harmonizohet me përparësi të tjera të Republikës së Shqipërisë, të tilla si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016–2020, Strategjia Kombëtare për Diasporën (2018–2024) dhe realizimi i Agjendës 2030, si dhe me aspiratat e vendit për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Strategjia përqendrohet në katër objektiva specifike, konkretisht: “garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri”; “garantimi i migracionit të sigurt e të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë”; “hartimi i politikave efektive për migracionin e punës duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit mbi zhvillimin social ekonomik kombëtar dhe lokal” dhe “nxitja dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integritit të tyre”.<sup>23</sup>

Përveç kësaj, Strategjia Kombëtare për Diasporën 2021–2025 (2020), synon të forcojë angazhimin e diasporës në politikat e migracionit dhe zhvillimit, duke e harmonizuar me interesat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me rëndësinë e ruajtjes së identitetit kombëtar. Për ta bërë këtë, ajo përcakton gjashtë objektiva: “forcimi dhe zhvillimi i raportit me diasporën shqiptare”; “mbështetja e aktiviteteve organizative në diasporë”; “krijimi i mekanizmave për lehtësimin dhe tërheqjen e investimeve nga diaspora”; “zbatimi i programeve për mësimin e gjuhës shqipe”; “informimi i diasporës rreth zhvillimeve social ekonomike në vendin e tyre të origjinës”; dhe “monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën”.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHI 2030), e miratuar në shkurt 2023, përcakton objektivat strategjike për të gjithë sektorët, përfshi migracionin, për periudhën 2023–2030. Për përcaktimin e objektivave të saj, SKZHI-ja mori parasysh Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit 2019–2022. Ajo përmban një rubrikë të titulluar “Menaxhimi i migracionit”, e cila eksploron situatën aktuale migratore të Shqipërisë dhe kuadrin ligjor të migracionit, duke identifikuar mangësitë e ndryshme lidhur me zbatimin me sukses të strategjisë kombëtare të migracionit në Shqipëri. Ajo synon t’i zbutë ato përmes “forcimit të mekanizmave e riintegritit për të garantuar një kthim të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë”, “forcimit të strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave të imigracionit për të siguruar integrimin e migrantëve në përputhje me standardet ndërkombëtare” dhe “harmonizimit të politikës migratore me politikën zhvillimore, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare”. SKZHI 2030 trajton po ashtu çështjet që lidhen me diasporën, duke përfshirë sigurimin e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë, si dhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit dhe marrëdhënies së tyre me vendlindjen.

Në Shqipëri ka institucione të ndryshme qeveritare që mbledhin të dhëna të lidhura me migracionin. Instituti i Statistikave (INSTAT) publikon çdo vit në faqen e tij të internetit të dhëna mbi numrin e popullsisë, përfshi të dhëna mbi migrantët dhe azilkërkuesit. Grupi i fundit i të dhënave u publikua në vitin 2022 për periudhën

<sup>21</sup> Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga këta anëtarë: Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Arsimit dhe Sportit, Ministri i Kulturës, Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Ministri i Shtetit për Diasporën (i cili nuk ekziston më), Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Drejtori i INSTAT-it.

<sup>22</sup> Grupi Ndërinstitucional i Punës përbëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

<sup>23</sup> Nga dhjetori 2022, Shqipëria po punon për hartimin e Strategjisë së re të Migracionit, pas përfundimit të vlerësimit të strategjisë aktuale.



2021 (INSTAT, 2022a, 2022b).<sup>24</sup> Në të njëjtën kohë, Ministria e Brendshme jep të dhëna përmes Profileve të Zgjeruara të Migracionit (publikuar së fundi në vitin 2019 për periudhën 2015–2018), që botohen çdo pesë vjet dhe përmes Profilit të Migracionit, që publikohet çdo vit (i fundit është publikuar në vitin 2016). Aktualisht, Ministria e Brendshme po punon për planin dhe metodologjinë e Profilit të ardhshëm të Zgjeruar të Migracionit, i cili do të botohet në vitin 2023 për periudhën 2019–2022.<sup>25</sup> E njëjta ministri, përmes Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit në varësi të Policisë së Shtetit, mbledh të dhëna në pikat kufitare dhe përmes aplikimeve për vizë dhe leje qëndrimi dhe administron Regjistrin Elektronik për të Huajt, ku regjistrohen të gjithë migrantët në vend, së bashku me statusin e tyre të qëndrimit. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë publike. Së fundi, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) boton një buletin statistikor vjetor (i fundit u botua në vitin 2022), i cili përmban të dhëna për emigrantët punëkërkuar të kthyer dhe të dhëna mbi lejet e punës, verifikimet dhe lejet e regjistrimit për punësim që iu janë dhënë shtetasve të huaj.

## 2.2. Fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm

Strategjia Kombëtare e Migracionit e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit 2019–2022 nuk merr parasysh migracionin si rezultat i efekteve negative të ndryshimeve klimatike ose degradimit mjedisor dhe nuk i përmend këto dukuri.

INSTAT nuk ka ngritur ende një mekanizëm dhe nuk ka hartuar udhëzime të qarta për të përpiluar, harmonizuar dhe standardizuar të dhënat për migracionin që mblidhen nga agjenci të ndryshme shtetërore.

Shqipëria ka një grup rregullash transparente dhe të aksesueshme për migracionit, por ato ende nuk janë të centralizuara dhe mbeten të shpërndara nëpër faqe të ndryshme qeveritare. Shqipëria vazhdon të bëjë përpjekje për të digjitalizuar procedurat dhe për të përmirësuar disponueshmërinë e informacionit publik dhe të shërbimeve elektronike përmes portalit “e-Albania”, i cili i ofron shërbimet përkatëse në shqip. Edhe dokumentet ligjore lidhur me migracionin mund të lexohen në gjuhën shqipe përmes Qendrës së Botimeve Zyrtare. Informacioni për procesin e vizave elektronike gjendet dhe mund të merret në internet në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen e internetit të Sistemit të Aplikimit për Vizë Elektronike. Ligji për të huajt (2021) në gjuhën shqipe dhe angleze gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme. Përveç kësaj, faqja e internetit e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka një rubrikë që iu dedikohet migrantëve me informacione për çështjet e shtetësisë, legalizimit dhe noterizimit të dokumenteve, regjimit të vizave për shtetasit e huaj, tarifën konsullore dhe të dhënat e kontaktit për zyrat e ndryshme ministrore, në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze. Së fundi, faqja e internetit e Policisë së Shtetit përfshin gjithashtu adresa interneti për ligjet përkatëse të migracionit. Në përgjithësi, zhvillimi i një portali online për të huajt për të aksesuar informacionin e centralizuar mbi rregullat e migracionit dhe shërbimet e ofruara, si dhe për të përdorur këto shërbime online, është një fushë me potencial për përparim të mëtejshëm.

<sup>24</sup> Të dhënat për migrantët përfshijnë numrin e migrantëve me leje qëndrimi në Shqipëri, të zbrërthyer sipas gjinisë dhe kontinentit të origjinës, numrin e kërkesave për leje qëndrimi, të zbrërthyer sipas vendit të origjinës, vendet kryesore të origjinës për migrantët në Shqipëri dhe numrin e migrantëve të parregullt të regjistruar, të zbrërthyer sipas vendit të origjinës. Të dhënat për azilkërkuarët përfshijnë numrin e azilkërkuarëve në Shqipëri, të zbrërthyer sipas vendit të origjinës, numrin e kërkesave mujore për azil dhe numrin e personave që kanë marrë dhe kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, të zbrërthyer sipas vendit të origjinës dhe moshës.

<sup>25</sup> Profili i Zgjeruar i Migracionit, 2015–2018 (2019), përmban, mes të tjerash, këto të dhëna: stoku migrator sipas gjinisë; shtetasit shqiptarë me qëndrim të rregullt në BE; urdhrat e largimit/dëbimit për shtetasit shqiptarë nga vendet e BE-së; shtetasit shqiptarë të ndaluar për kohësisht kur largohen nga territori; të miturit e pashoqëruar me shtetësi shqiptare të pranishëm në territorin italian; azilkërkuarët me shtetësi shqiptare në vendet e BE-së të konsideruar si të mitur të pashoqëruar; marrja e shtetësisë së vendit pritës nga shtetasit shqiptarë; shtetasit shqiptarë të kthyer sipas grup moshës dhe gjinisë; kthimet e të miturve shqiptarë të pashoqëruar sipas vendit; migracioni i brendshëm neto sipas qarkut; të huajt me qëndrim në vend sipas shtetësisë; të huajt që studiojnë në Shqipëri; të huajt me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri; azilkërkuarët e huaj në Shqipëri sipas kombësisë; të huajt e ndaluar në kufi ose në territorin shqiptar; të huajt të cilëve u është refuzuar hyrja sipas arsyes; statistika për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; lëshimi i lejeve të punës sipas kombësisë; të huajt me qëndrim në Shqipëri sipas origjinës; të huajt me qëndrim në Shqipëri sipas grup moshës; lejet e qëndrimit për të huajt sipas motivit; lejet e qëndrimit për të huajt sipas gjinisë; dinamikat e dërgesave nga emigrantët shqiptarë.



## 3

## ANGAZHOHET ME PARTNERËT PËR TRAJTIMIN E ÇËSHTJEVE TË MIGRACIONIT DHE ÇËSHTJET E LIDHURA ME TË

### 3.1. Qeverisja e migracionit: shembuj të fushave të zhvilluara mirë

Shqipëria është pjesë e disa proceseve dhe forumeve rajonale. Ajo është pjesë e Procesit të Budapestit, i krijuar në vitin 1993 si “instrument për ndarjen e informacionit midis vendeve evropiane në periudhën përpara zgjerimit të BE-së dhe forum për përmirësimin e menaxhimit të migracionit”.<sup>26</sup> Po ashtu, Shqipëria është pjesë e Procesit të Pragës, i krijuar në vitin 2009 si proces konsultues mbi migracionin, i cili mbulon 50 shtete evropiane, me synim “për të forcuar bashkëpunimin në menaxhimin e migracionit dhe për të shqyrtuar dhe hartuar parime dhe elemente të pranuar gjerësisht për partneritete të ngushta për migracionin midis shteteve pjesëmarrëse”. Që prej vitit 2003, Shqipëria është anëtare e Nismës Rajonale për Migracionin, Azilin, Refugjatët (MARRI), së bashku me Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Kosovën.<sup>12</sup> MARRI u krijua me mandatin për “të nxitur një bashkëpunim më të ngushtë rajonal dhe qasje të përbashkët, të gjithanshme dhe të harmonizuar të pjesëtarëve të MARRI-t në fushën e migracionit, azilit, kontrollit të kufirit, trafikimit të qenieve njerëzore, regjimit të vizave dhe integritit e kthimit të refugjatëve”, me qëllimin për të arritur standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Ajo synon të sigurojë “lëvizje të lirë dhe të mirë menaxhuar të personave në Ballkanin Perëndimor”. Së fundi, Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) që prej vitit 2014 dhe, si e tillë, është palë në shumë procese rajonale, përfshi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, nënshkruar në vitin 2009 për të forcuar bashkëpunimin në administrimin e vizave, kontrollin e kufirit, azilin dhe migracionin dhe për të parandaluar migracionin e parregullt.

Si rezultat i pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e gjashtë Ministrave të Procesit të Budapestit në vitin 2019, thuhet se 40 vende, përfshi Shqipërinë, miratuan Angazhimet e Stambollit për Partneritetin e Rrugës së Mëndafshit për Migracionin dhe planin e veprimit, të cilat përmbajnë gjashtë fusha kryesore bashkëpunimi. Në veçanti, vendet kanë rënë dakord të përmirësojnë kushtet për migracionin e rregullt dhe lëvizshmërinë, të nxitin vlerësimet e tregut të punës dhe marrëveshjet e lëvizshmërisë, të hartojnë programe për migracionin qarkullues dhe të përkohshëm, të rritin lëvizshmërinë e studentëve dhe të lehtësojnë lëvizshmërinë e mirë menaxhuar të udhëtarëve të mirëfilltë, përfshi studentët, studiuesit dhe njerëzit e biznesit, duke përmirësuar transparencën e rregullave dhe të procedurave.

Shqipëria angazhon zyrtarisht pjesëtarët e diasporës dhe komuniteteve të emigrantëve për përcaktimin e agjendës dhe zbatimin e politikave për zhvillim përmes organizimeve të konsultimeve zyrtare. Që prej vlerësimit të mëparshëm të MGI-së, në vitin 2020 u krijua Këshilli Koordinues i Mësuesve në Diasporë, si pjesë e Qendrës së Botimeve për Diasporën, me qëllim përmirësimin e cilësisë së politikave arsimore në komunitetet shqiptare në diasporë. Po ashtu, në vitin 2018, Shqipëria ngriti Këshillin Koordinues të Diasporës, që përbëhet nga persona të shquar të diasporës në fusha të ndryshme, si arsimit, teknologjia, shkenca dhe filantropia dhe promovon interesat e diasporës përmes aktiviteteve të ndryshme. Përveç kësaj, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizon aktivitete të ndryshme me synim lidhjen me shtetasit që jetojnë jashtë dhe ushtrojnë profesione të caktuara. Për shembull, në vitin 2021 u zhvilluan dy takime profesionale: njëri synonte të nxiste avokatët që punonin në diasporë të shkëmbejnë përvojat dhe tjetri mblodhi bashkë mjekë në diasporë dhe përqendrohej te menaxhimi i pandemisë COVID-19. Në vitin 2016 dhe 2019, në Shqipëri u organizua samiti i parë dhe i dytë i diasporës në Tiranë, që përfshiu përfaqësues të organizatave nga diaspora, si dhe përfaqësues të qeverisë nga vendet fqinje. Agjencia Kombëtare për Diasporën ka në faqen e vet të internetit një listë organizatash të diasporës, përfshi të dhënat e kontaktit për secilën prej tyre. Shqipëria ka një sërë memorandumesh mirëkuptimi në fuqi (MM) me vendet e destinacionit dhe aktualisht po kërkon të negociojë disa marrëveshje me vendet e origjinës. Që prej vlerësimit të mëparshëm

<sup>26</sup> Deri më 23 shkurt 2023, ajo numëron 51 vende anëtare dhe 7 vende vëzhguese.



të MGI-së, më 5 shkurt 2021 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen për Partneritet, Tregti dhe Bashkëpunim midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, e cila ka hyrë në fuqi më 3 maj 2021. Përveç kësaj, më 16 maj 2022, Shqipëria nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit midis Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime lidhur me Migracionin, e cila plotëson Marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për riatdhesimin e personave dhe protokollet e saj (2005).

Shqipëria merr pjesë në bisedimet dypalëshe për migracionin me vendet e origjinës, të tilla si Afganistani, Algjeria, Bangladeshi, Egjipti, India, Iraku, Maroku, Pakistani, Tunizia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Për më tepër, që prej vitit 2014, Shqipëria ka marrë pjesë në forume lidhur me procesin e zgjerimit të BE-së, si Procesi i Berlinit,<sup>27</sup> i cili ka zhvilluar samite vjetore me vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova) dhe shtetet anëtare të BE-së.<sup>28</sup>

Që nga vlerësimi i mëparshëm i MGI-së, Shqipëria është bërë pjesë e nismës Ballkani i Hapur, një marrëveshje rajonale që nxit lëvizshmërinë për motive punësimi. Procesi Ballkani i Hapur nisi në vitin 2019 pas një takimi trepalësh të udhëheqësve të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Ka pasur përpjekje për të përfshirë edhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor përmes disa takimeve ndërqeveritare, konkretisht, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Kosovën.<sup>12</sup> Si rezultat i këtyre proceseve, Shqipëria ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi dhe marrëveshje mbi turizmin, administrimin tatimor, import-eksportin e mallrave, qasjen e lirë në tregjet e punës dhe skemat e ndërlidhjes për identifikimin elektronik të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja e vitit 2021 për Qasjen e Lirë në Tregun e Punës në Ballkanin Perëndimor, e nënshkruar nga kryeministrat e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, synon të lehtësojë “procedurat administrative për hyrjen, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e qytetarëve të Palët e tjera Kontraktuese” dhe krijon bazën për numrin e identitetit të Ballkanit të Hapur, që nxirret nga vendi kontraktues prej nga vjen qytetari për të lehtësuar lëvizjen e punonjësve.<sup>29</sup>

### 3.2. Fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm

Vendi i angazhon organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe sektorin privat në mënyrë të kufizuar dhe rastësore kur bëhet fjalë për përcaktimin e agjendës dhe zbatimin e çështjeve që lidhen me migracionin. Sekretariati Teknik për Migracionin, në varësi të Ministrisë së Brendshme, është ngarkuar të mbajë dy takime në vit me OShQ-të dhe partnerët e tjerë, përfshi sektorin privat, për të monitoruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019–2022, gjë e cila nuk është bërë sipas planit. Përveç kësaj, “gjatë procesit të hartimit të strategjisë, janë mbajtur një sërë takimesh konsultimi me shoqërinë civile, përfaqësues të biznesit, botën akademike dhe studiues, si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe ambasadave në Shqipëri”. Gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare shqiptare të Diasporës, 2021–2025 (2020) u konsultuan OShQ-të dhe aktorë të sektorit privat. OShQ-të, partnerët nga bota akademike dhe sektori privat pritet po ashtu të marrin pjesë në konsultimet për hartimin e strategjisë së re të migracionit në vitin 2023. Megjithatë, Strategjia Kombëtare për Migracionin 2019–2022 (2019) shprehet se “roli i aktorëve jo shtetërorë (OJQ-të dhe sektori privat) për zbatimin e politikave ka qenë i kufizuar dhe i një natyre rastësore”.

<sup>27</sup> Ai ndodhet këtu.

<sup>28</sup> Samitet përfshijnë takime të krerëve të qeverive, instituteve studimore, organizatave joqeveritare dhe komunitetit të biznesit dhe synojnë t'i sjellin vendet e Ballkanit Perëndimor më pranë anëtarësimin në BE dhe të krijojnë mundësi për të diskutuar çështjet e migracionit dhe të kufirit.

<sup>29</sup> Skema e numrit të identitetit të Ballkanit të Hapur nuk ishte zbatuar ende deri në shkurt 2023. Qëllimi është që pajisja me këtë numër t'i lejojë qytetarët “të punojnë në sektorin privat të secilit prej këtyre tri vendeve, pa njohjen e diplomave, pa u dashur të presin lejet e ndryshme dhe pa u përballur me pengesa administrative”.



## 4

RRIT MIRËQENIEN SOCIALEKONOMIKE TË MIGRANTËVE  
DHE SHOQËRISË

## 4.1. Qeverisja e migracionit: shembuj të fushave të zhvilluara mirë

Shqipëria ka miratuar kritere dhe procedura për akreditimin e diplomave dhe kualifikimeve të marra në vende të tjera. Që nga viti 2019, procesi i aplikimit për njohjen e diplomave të huaja kryhet tashmë plotësisht online përmes portalit të qeverisë shqiptare në internet, “e-Albania”.<sup>30</sup> Qendra e Shërbimeve Arsimore, e krijuar në vitin 2017, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë, është përgjegjëse për njohjen e diplomave nga jashtë, me përjashtim të doktoraturave, të cilat janë nën juridiksionin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Procedura e aplikimit përshkruhet qartë në gjuhën shqipe dhe angleze në portalin “e-Albania”, përfshi informacione mbi dokumentet e nevojshme për t’u paraqitur për diploma të ndryshme, përfshi atë *Bachelor*, *Master*, Doktoraturë dhe tituj të tjerë akademikë. Përveç kësaj, në vitin 2022, Shqipëria miratoi Marrëveshjen e Bashkëpunimit në Fushën e Njohjes së Ndërsjellë të Diplomave dhe Kualifikimeve Shkencore të nxjerra nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Institucionet e Autorizuara në Ballkanin Perëndimor, që synon të lehtësojë njohjen e diplomave nga Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut.

Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe institucional që promovon rekrutimin etik të migrantëve. Ligji Nr. 79, “Për të huajt” (2021) përcakton kushtet përkatëse që duhen verifikuar nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA). Sipas neneve 74.7b dhe 74.11 të ligjit, lejet “për punonjësit e huaj [miratohen vetëm nëse ata] nuk punësohen me kushte më pak të favorshme sesa punonjësit shqiptarë për të njëjtin pozicion dhe do të kryhet shqyrtimi i pagave, orëve të punës dhe kushteve të tjera të punësimit” dy javë pas kërkesës së AKPA-s. Po kështu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (1995) u përditësua në vitin 2016 për të sanksionuar “ndalimin e diskriminimit dhe zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë gjatë ushtrimit të së drejtës për punësim dhe ushtrimit të profesionit për të gjitha punësimet, vetëpunësimet dhe profesionet në fazat e rekrutimit” (neni 9.5). Përveç kësaj, Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Migracionin 2019-2022 (2019) kërkon “të sigurohet që operatorët privatë të zbatojnë standardet e rekrutimit etik duke monitoruar aktivitetin e tyre rregullisht” dhe “të hartojnë udhëzime standarde për intervistimin e punonjësve migrantë për të identifikuar rastet e shfrytëzimit ose të diskriminimit”. Sipas strategjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë “monitoron funksionimin e agjencive të punësimit, për të garantuar rekrutimin etik të punonjësve migrantë”. Së fundi, në periudhën 2021–2022, qeveria, në bashkëpunim me IOM-in, u përpoq të promovonte praktikën më të mira të rekrutimit për punonjësit migrantë dhe hartoi udhëzimet për rekrutimin etik.

Shqipëria ka miratuar një sërë masash zyrtare për nxitjen e barazisë gjinore për migrantët në forcën e punës. Ligji Nr. 9970, “Për barazinë gjinore në shoqëri” (2008) nxit barazinë gjinore për të gjithë punonjësit dhe sanksionon të drejtën “për të mos u diskriminuar apo për të mos u pushuar nga puna për shkak të martesës apo shtatzënisë apo lindjes dhe garantimin e të drejtës efektive për të punuar” (neni 21.e). Ai parashikon që “personat e huaj fizikë dhe juridikë me qëndrim, vendbanim apo seli jashtë Republikës së Shqipërisë gëzojnë mbrojtjen e ofruar nga ligji në raport me organet shtetërore shqiptare” (neni 5). Më tej, Strategjia Kombëtare për Migracionin, 2019–2022, pranon se gratë përballen me një rrezik më të lartë papunësie. Në kuadrin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019–2022 (2019), Ministria e Financave dhe Ekonomisë ngarkohet me “hartimin dhe zbatimin e masave të synuara për nxitjen e qasjes së grave migrante në tregun shqiptar të punës”. Bazuar në raportin e monitorimit të strategjisë në vitin 2022, kjo është arritur përmes vlerësimit të “akteve ligjore ekzistuese, procedurave administrative dhe skemave ndihmëse të punësimit” dhe përmes identifikimit “të pengesave për punësim dhe mbrojtjes së të drejtave të grave në tregun e punës (duke u përqendruar te imigrantët)”. Gjithashtu, raporti shprehet se

<sup>30</sup> Ai ndodhet këtu.

Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi duhet “të marrë parasysh trajnimin e asistentëve femra që do të zhvillojnë konsultime me imigrantët, të cilat do të botojnë fletëpalosje në gjuhët kryesore që flasin imigrantët për t’i informuar ata për kontaktet me institucionet shtetërore dhe OJQ-të që ndihmojnë për gjetjen e punësimit”. Së fundi, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 (2021), hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, synon të zbutë “pengesat që i mbajnë gratë dhe vajzat larg tregut të punës”, si dhe të rritë “mundësinë e grave dhe vajzave të të gjitha grupeve për punë të denjë në të gjithë sektorët e punësimit (veçanërisht, në shkenca, teknologji, inxhinieri, matematikë)”, përfshi gratë migrante. Aktivitetet që duhen zhvilluar për të përmbushur këto objektiva përfshijnë prodhimin e fletëpalosjeve për gratë, përmirësimin e programeve qeveritare, shtimin e kopshteve dhe objekteve të kujdesit për fëmijët dhe sigurimin e personelit të mjaftueshëm të institucioneve përkatëse.

## 4.2. Fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm

Në Shqipëri nuk janë kryer vlerësime kombëtare për monitorimin e rregullt të kërkesës për imigrantë në tregun e punës. Edhe pse Ligji Nr. 79, “Për të huajt”, përcakton se “Leja unike për të huajin, brenda kuotave të caktuara, lëshohet duke mbajtur parasysh zhvillimet dhe nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë” dhe se Agjencia për Punësim dhe Aftësi do t’i miratojë aplikimet vetëm nëse janë brenda “kuotave të miratuara vjetore”, ai nuk krijon një mekanizëm për të vlerësuar tregun e punës në baza të rregullta. Instituti shqiptar i Statistikave (INSTAT) zhvillon një anketë kombëtare dhe tremujore të forcës së punës. Megjithatë, ajo nuk përbën një vlerësim kombëtar që monitoron kërkesën e tregut të punës për imigrantët.

Kryerja e vlerësimeve kombëtare për monitorimin e ofertës për punë në vend dhe efektet e emigrantëve në tregun e punës është një fushë me potencial për zhvillim të mëtejshëm. Agjencia për Punësim dhe Aftësi publikon një raport vjetor, “Analiza vjetore e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe ecuria e aktiviteteve”, që është botuar së fundi në vitin 2020 dhe përfshin të dhëna për tregun e punës, numrin e personave të papunë, vendet e lira të punës dhe të dhëna për programet e saj. Për më tepër, anketa tremujore kombëtare e INSTAT-it për forcën e punës u publikua së fundi në vitin 2022. Asnjëri nga botimet nuk e analizon ofertën e brendshme të tregut të punës dhe efektet e emigrantëve në tregun e brendshëm të punës. Në periudhën 2021–2022, Shqipëria bashkëpunoi me IOM-in për të forcuar kapacitetet e vendit për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, duke u përqendruar veçanërisht te migracioni i punës dhe te analiza e ndikimit të migracionit në tregun e punës dhe struktura e forcës së punës.

Shqipëria nuk mundëson akses të barabartë në arsimin universitar për të gjithë studentët ndërkombëtarë. Ajo ka caktuar kuota për studentët ndërkombëtarë, duke iu dhënë përparësi studentëve që vijnë nga Ballkani Perëndimor.



## 5

## TRAJTON EFEKTIVISHT DIMENSIONIN E LËVIZSHMËRISË SË KRIZAVE

## 5.1. Qeverisja e migracionit: shembuj të fushave të zhvilluara mirë

Komiteti ndërministror i Emergjencave Civile në Shqipëri është organizmi më i lartë për bashkërendimin e institucioneve dhe administrimin e Sistemit të Mbrojtjes Civile në rast emergjencash. Ky komitet drejtohet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri ose një ministër i caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe mbledhet në rast emergjence. Këshilli i Ministrave miraton në bashkërendim “strategjitë, politikat dhe programet që synojnë të parandalojnë, të lehtësojnë, të përgatitin dhe t’u përgjigjen situatave të emergjencës”,<sup>31</sup> ndërkohë që ministria përgjegjëse për pushtetin vendor monitoron situatën e emergjencës dhe bashkërendohet me organet e tjera të përfshira për menaxhimin e emergjencës në nivel vendor. Njësia e Planifikimit dhe Reagimit ndaj Emergjencave Civile në Drejtorinë e Reagimit, Gatishmërisë dhe Bashkërendimit të Emergjencave në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes është përgjegjëse për reagimin e menjëhershëm gjatë emergjencave, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është përgjegjëse për të hartuar planet e menaxhimit të emergjencave dhe për t’u siguruar për zbatimin e tyre.

Plani Kombëtar i Shqipërisë për Emergjenat Civile (2004) është kuadri kombëtar i menaxhimit të emergjencave, i cili përmban masa konkrete për të ndihmuar migrantët në vend. Ai synon “të parandalojë, të lehtësojë dhe garantojë rimëkëmbjen nga çdo dëm që prek popullsinë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, si rezultat i emergjencave civile” (pika 1.2, Qëllimi, objektivat dhe parimet). Sipas planit, Ministria e Shëndetësisë ngarkohet të bashkëpunojë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme “për të identifikuar dhe trajtuar personat e lënduar ose viktimat që janë shtetas të huaj, si dhe të lehtësojë procedurat për ekipet ndërkombëtare të ndihmës mjekësore dhe spitalet provizore”. Po ashtu, ai parashikon se, në rast emergjencash, autoritetet shqiptare nuk bëjnë asnjë dallim midis shtetasve shqiptarë dhe migrantëve. Njëkohësisht, Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 45, “Për mbrojtjen civile” (2019), i cili synon “të ulë rrezikun nga katastrofat dhe të garantojë mbrojtje për qytetarët duke forcuar sistemin e mbrojtjes civile”. Neni 4 përcakton se “çdokush ka të drejtën të mbrohet nga katastrofat natyrore apo të llojeve të tjera” dhe neni 57 parashikon shprehimisht se “çdo subjekt, vendas ose i huaj, në rast katastrofash, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje për vete dhe pronën e tij nga strukturat e mbrojtjes civile”.

“Plani i kontingjencës për një fluks të mundshëm të madh migrantësh dhe azilkërkuessish në kufirin shqiptar” (2021) përditësohet rregullisht, edhe pse ende nuk është miratuar zyrtarisht nga qeveria. I hartuar nga Ministria e Brendshme, Plani i Kontingjencës ka për qëllim të garantojë të drejtat e migrantëve dhe azilkërkuessve në Shqipëri, duke përmirësuar kapacitetet për të identifikuar, përpunuar dhe ofruar shërbime migrantëve dhe azilkërkuessve dhe përmes krijimit të një mjedisi ku migrantët të ndihen të sigurt.

Në vitin 2019, Ministria e Mbrojtjes krijoi Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, e cila është e ngarkuar “të komunikojë me qendrat ndërkombëtare të informacionit dhe të bashkërendimit të reagimit”, “të organizojë fushata informimi/ndërgjegjësimi për masat që duhen marrë për të parandaluar dhe përballuar katastrofat” dhe për të bashkëpunuar me “bashkitë, prefekturat, institucionet qendrore, sektorin privat dhe organizatat e ndryshme për t’u siguruar që informacioni t’i shpërndahet popullsisë gjatë krizave”. Për ta bërë këtë, Agjencia publikon njoftime për shtyp lidhur me reagimet ndaj katastrofave në faqen e vet të internetit<sup>32</sup> dhe ka në funksionim numrin kombëtar 112 për shërbimet e emergjencës.

Shqipëria iu ofron mbrojtje të përkohshme personave që largohen nga lufta ose nga kriza të ngjashme dhune ose konflikti në vendet e tyre, të cilët nuk mund të garantojnë mbrojtjen e tyre sipas Ligjit Nr. 10,

<sup>31</sup> Ky informacion është marrë nga Plani Kombëtar i Emergjencave Civile (2004).

<sup>32</sup> Ai ndodhet këtu.

“Për azilin” (2021). Sipas nenit 82, mbrojtja e përkohshme jepet fillimisht për një afat njëvjeçar dhe mund të shtyhet me gjashtë muaj për një maksimum prej tre vitesh. Të drejtat e personave nën mbrojtje të përkohshme parashikohen në nenin 86 dhe përfshijnë: qëndrimin në Republikën e Shqipërisë në përputhje me kohëzgjatjen e mbrojtjes së përkohshme; kushtet bazë të jetesës dhe strehimit; përfitimin e kujdesit shëndetësor; aksesin në arsimin para universitar me të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë; ushtrimin e lirisë së mendimit dhe lirisë së fesë sipas besimeve të tyre; të punojnë dhe të kenë akses në arsimin profesional; të drejtën e ndihmës shtetërore të garantuar nga shteti. Në mars 2022, Shqipëria e zbatoi këtë dispozitë për mbrojtjen e shtetasve të larguar nga lufta në Ukrainë përmes miratimit të Vendimit Nr. 169 (2022) dhe Vendimit Nr. 173 (2022) që u jep të gjithë shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë përfituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë mbrojtje të përkohshme dhe strehim në Shqipëri për një periudhë njëvjeçare. Po kështu, sipas Vendimit Nr. 169 (2022), shtetasit ukrainas nuk kërkohet të jenë të pajisur me pasaporta biometrike për të hyrë në Shqipëri.

## 5.2. Fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm

Aktualisht Shqipëria nuk ka politika mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike që marrin parasysh çështjet e lëvizshmërisë së njerëzve si përgjigje për parandalimin e krizave. Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHI) 2030 përcakton se “mbrojtja mjedisore është një nga sektorët parësorë të identifikuar në programin e qeverisë për dekadën e ardhshme”, por nuk përmend migrantët apo zhvendosjen. Strategjia e Shqipërisë për Ndryshimin e Klimës dhe Plani i saj i Veprimit (2019) i referohet lëvizshmërisë së personave sa i takon përmirësimit të transportit dhe një lëvizshmërie më të mirë në përgjithësi, por nuk përfshin dispozita sa i takon lëvizshmërisë apo rivendosjes për shkak të katastrofave natyrore. Së fundi, Ligji Nr. 45, “Për mbrojtjen civile” (2019) nuk iu referohet migrantëve ose zhvendosjes në këtë drejtim.

Plani Kombëtar i Shqipërisë për Emergjencat Civile (2004) parashikon përgjigjen dhe rimëkëmbjen pas emergjencës, por nuk përmban parashikime konkrete për migrantët. Ai pranon se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme duhet të identifikojë migrantët në nevojë për ndihmë pas ngjarjes, por nuk përcakton ndonjë nismë konkrete në procesin e rimëkëmbjes. Po ashtu, projektplanin e kontingjencës për një fluks të mundshëm të madh të migrantëve dhe azilkërkuesve në kufirin shqiptar nuk trajton specifikisht menaxhimin e katastrofës në prag të katastrofave natyrore.

Edhe pse Shqipëria ka sisteme komunikimi të krijuara për shpërndarjen e informacionit gjatë krizave, duke marrë parasysh dobësitë specifike me të cilat përballen migrantët, kjo është një fushë me potencial për zhvillim të mëtejshëm.



## 6

## GARANTON QË MIGRACIONI TË ZHVILLOHET NË MËNYRË TË SIGURT, TË ORGANIZUAR DHE TË RREGULLT

### 6.1. Qeverisja e migracionit: shembuj të fushave të zhvilluara mirë

Shqipëria ka miratuar masa për t'u siguruar që ndalimi i migrantëve të përdoret vetëm si zgjidhje e fundit. Sipas nenit 115 të Ligjit Nr. 79, "Për të huajt" (2021), "ndalimi në qendrën e mbyllur është masa e fundit administrative" që merret vetëm kur janë shteruar të gjitha masat e mundshme alternative". Ky ligj përfshin po ashtu dispozita të veçanta lidhur me ndalimin e fëmijëve migrantë, të cilat parashikojnë se "vetëm në raste përjashtimore, një i mitur i pashoqëruar mund të mbahet në një qendër sociale shtetërore të ngritur veçanërisht për këtë qëllim ose në një qendër tjetër, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, që angazhohen në misionet për mbështetjen e fëmijëve, viktimave të trafikimit ose kategorive të tjera në nevojë". Gjithashtu, ligji kërkon që të konsultohet një punonjës social dhe një psikolog përpara ndalimit të të miturve në qendrat e mbyllura të pritjes.

Që nga vlerësimi i mëparshëm i MGI-së, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e saj të Veprimit 2021–2022 (2020) për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Të hartuara nga Ministria e Brendshme, këto strategji synojnë "të sigurohen që qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërore dhe jo shtetërorë të angazhohen dhe të përkushtohen për të parandaluar dhe për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe të sigurojnë mbrojtjen e individëve dhe grupeve në nevojë nga trafikimi". Aktivitetet kryesore përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve përkatëse, si dhe të kompanive private për identifikimin e rreziqeve të trafikimit, miratimin ose ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve dhe trajnimin e profesionistëve që punojnë me viktimat e trafikimit, përfshi gratë, burrat dhe fëmijët. Strategjia përmend shprehimisht migrantët në kuadër të objektivit të saj për të siguruar "trajnimin e oficerëve të policisë së kufirit dhe migracionit, zyrtarëve të doganave, zyrtarëve të azilit dhe personelit të qendrave të pritjes dhe strehëzave për të rritur kapacitetet për identifikimin e viktimave të trafikimit mes azilkërkuesve, migrantëve dhe fëmijëve të pashoqëruar".

Shqipëria ka në fuqi politika dhe procedura për identifikimin në kohë të migrantëve në situata në nevojë dhe për t'u ofruar atyre shërbimet e duhura të referimit dhe të mbrojtjes. Policia e Kufirit dhe Migracionit kryen intervista vlerësimi paraprak në pikat e hyrjes për të identifikuar personat e cenusëshëm që kanë nevojë për ndihmë dhe, më tej, është përgjegjëse për dhënien e lejeve të qëndrimit të përkohshëm të tipit "A", të vlefshme për tre muaj viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit, sipas nenit 53 të Ligjit Nr. 79, "Për të huajt". Autoritetet mund të zgjatën vlefshmërinë e lejes kur e konsiderojnë të nevojshme për shkak të kushteve sociale të viktimës. Së fundi, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit administron dy Qendra Regjistrimi dhe Pritjeje të Përkohshme, njëra e ngritur në vitin 2017 dhe tjetra në vitin 2019, të cilat shërbejnë si qendra përpunimi për migrantët e parregullt dhe ofrojnë shërbime urgjente të kujdesit shëndetësor.

Shqipëria ka forcuar procedurat dhe masat që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve migrantë, përfshi fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë. Ligji Nr. 18, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" (2017) garanton mbrojtjen e "fëmijës me nënshtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj" dhe përmend njësitë vendore të Agjencisë Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si organet përgjegjëse për ta garantuar këtë. Njëkohësisht, Ligji Nr. 10, "Për azilin" (2021) forcon qasjen me në qendër fëmijën të legjislacionit shqiptar, duke përcaktuar se të miturit e pashoqëruar nuk duhen intervistuar pa praninë e një punonjësi të trajnuar social nga Agjencia Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe përcakton se vëllezërit/motrat nuk duhet të ndahen me forcë, duke siguruar interesin më të mirë të fëmijës.

## 6.2. Fushat me potencial për zhvillim të mëtejshëm

Shqipëria ka masa për tërheqjen e shtetasve që kanë emigruar në vende të tjera, por ato mbeten të kufizuara dhe spontane. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019–2022 (2019) nuk përmbajnë masa përkatëse në këtë drejtim, edhe pse Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021–2025 (2020) përfshin masa për lehtësimin dhe nxitjen e kthimit të emigrantëve të kualifikuar në Shqipëri. Për shembull, strategjia parashikon nevojën “për të vlerësuar kërkesën dhe ofertën për personel të kualifikuar në tregun shqiptar të punës dhe për të promovuar kontaktin midis emigrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha në Shqipëri”. Për ta bërë këtë, Shqipëria po punon për ngritjen e një baze elektronike të dhënash me jetëshkrimet e profesionistëve të diasporës. Megjithatë, një mekanizëm gjithëpërfshirës i përqendruar te tërheqja e qytetarëve që kanë migruar nga Shqipëria është një fushë për zhvillim të mëtejshëm.

Megjithëse Strategjia Kombëtare e Migracionit 2019–2022 (2019) trajton ri integrimin e shtetasve të kthyer, veprimet specifike në lidhje me këtë aspekt nuk u ekzekutuan siç ishte planifikuar. Objektivi C i strategjisë fokusohet në zhvillimin e një politike efektive të migracionit për motive punësimi dhe përmirësimin e ndikimit pozitiv të migracionit. Aty përmenden disa veprime që lidhen me lehtësimin e kthimit dhe riintegrimin socio-ekonomik të qytetarëve shqiptarë, si vlerësimi i nevojave të tyre për punësim, krijimi i fondeve për mbështetjen e bizneseve të vogla për të kthyerit, krijimi i paketave të informacionit dhe nxitja e përdorimit të remitancave. Sidoqoftë, shumica e aktiviteteve në lidhje me zhvillimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës për integrimin e të kthyerve nuk janë zbatuar. Objektivat C dhe D<sup>33</sup> të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019–2022 (2019) ishin ato më pak të zbatuara në përgjithësi. Ka potencial për përfshirjen e këtyre objektivave në Strategjinë e re për Migracionin për të siguruar zbatimin e tyre.

Shqipëria nuk ka ende sisteme zyrtare në fuqi, përfshi marrëveshjet zyrtare të bashkëpunimit me vende të tjera, për të gjurmuar dhe për të identifikuar migrantët ndërkombëtarë që kanë humbur gjatë procesit të migrimit në territorin e vendit dhe e bën këtë kryesisht rast pas rasti. Shqipëria mund të mbrojë vetëm ata migrantë që hyjnë rregullisht në vend dhe regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar për të Huajt, bazën shtetërore të të dhënave të Ministrisë së Brendshme që përmban të dhënat për migrantët që hyjnë në Shqipëri për të qëndruar, për të kaluar tranzit, për të punuar dhe për të studiuar. Megjithatë, në raste të veçanta, Ministria e Brendshme mund të trajtojë kërkesa nga institucione vendase ose të huaja për të gjurmuar dhe për të identifikuar individë, me kusht që qeveritë e huaja të kenë të dhëna për identitetin e tyre.

<sup>33</sup> Objektivi D fokusohet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre.



## Pas vlerësimit të MGI-së

IOM-i dëshiron të falënderojë qeverinë e Republikës së Shqipërisë për angazhimin e saj në këtë proces. IOM-i shpreston që rezultatet e këtij vlerësimi t'i shërbejnë forcimit të qeverisjes së migracionit nga ana e qeverisë. Pas vlerësimit të MGI-së, rekomandohet sa vijon:



Raporti i MGI-së mund të përdoret si informacion për punën me politikatat, me mbështetjen e IOM-it (nëse dëshirohet).



Gjetjet mund të kontribuojnë për aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve, të cilat mund të lidhen me nisma të tjera të IOM-it.



Pas tre vjetësh mund të kryhet një vlerësim vijues, për të verifikuar ecurinë e arritur.



Qeveritë mund të shkëmbejnë praktikatat më të mira dhe zgjidhjet novatore me qeveritë të tjera që e kanë kryer procesin e MGI-së.





BURIMET  
KRYESORE\*

*\* Të gjithë linket funksiononin në kohën kur u shkrua ky raport.*

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile  
n.d. Sistemi i mbrojtjes civile.

Agjencia Kombëtare për Diasporën  
n.d.a Lista e organizatave të diasporës.  
n.d.b Misioni. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Shqipëri.

Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi  
2020a Analiza vjetore e Agjencisë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive mbi ecurinë e aktiviteteve për vitin 2020.  
2022b Buletini statistikor 2021.  
2022c Strategjia 2019–2022: Raporti vjetor i ecurisë 2021.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara  
2015 Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development. A/RES/70/1.

Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT)  
2022a Të huajt në Shqipëri 2021.  
2022b Azilkërkuesit në Shqipëri 2021.  
2022c Anketa tremujore e forcës së punës, T3 – 2022.  
2022d Tregu i Punës 2021.

Komisioni Evropian  
2009 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Ministria e Brendshme  
2018 Takime konsultuese për hartimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave, 2018–2020. 22 Shkurt.  
2020a Profili i Zgjeruar Kombëtar i Migracionit, 2015–2018.  
2020b Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, 2019–2022.

Ministria e Mbrojtjes  
2004 Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme  
n.d.a Misioni dhe funksioni.  
n.d.b Struktura funksionale.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)  
2019a The Istanbul Commitments on the Silk Routes Partnership for Migration and Its Call for Action: A Five-year Plan. Budapest Process 6th Ministerial Conference, Istanbul, 19–20 February.  
2019b Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019–2022. IOM Tiranë, Shqipëri.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri  
2018 Nevojat për aftësi në Shqipëri 2017.

Qeveria e Shqipërisë, Qeveria e Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Serbisë  
2021 Marrëveshje për kushtet e hyrjes së lirë në tregun e punës së Ballkanit Perëndimor.  
2022 Agreement on Cooperation in the Western Balkans in the Field of Mutual Recognition of Diplomas and Scientific Grades Issued by Higher Education Institutions and Other Authorized Institutions.

Qeveria e Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar  
2022 UK–Albania joint communique: Enhancing bilateral cooperation in areas of common interest. 13 Dhjetor.

## Qeveria shqiptare

- 1993 Ligji Nr. 7703, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".
- 1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- 2001 Ligji Nr. 8834, "Për ratifikimin dhe njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë".
- 2003 Ligji Nr. 9066, "Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për mbrojtjen sociale.
- 2005 Ligji Nr. 9350, "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për Ripranimin e Personave, dhe protokolleve të saj". Nuk gjendet online.
- 2006 Ligji Nr. 9668, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".
- 2008 Ligji Nr. 9970, "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- 2009 Ligji Nr. 10 107, "Për kujdesin shëndetësor".
- 2010 Ligji Nr. 10 221, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- 2011 Ligji Nr. 10 383, "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor.
- 2012 Ligji Nr. 69, "Për arsimin parauniversitar".
- 2013 Ligji Nr. 152, "Për nëpunësit civilë".
- 2014 Ligji Nr. 35/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për sigurimet shoqërore".
- 2015a Ligji Nr. 42/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për sigurimet shoqërore".
- 2015b Ligji Nr. 151/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për sigurimet shoqërore".
- 2015c Ligji Nr. 123/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për sigurimet shoqërore".
- 2016a Kodi i Punës.
- 2016b Ligji Nr. 14, "Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë.
- 2016c Ligji Nr. 23/2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për sigurimet shoqërore dhe protokollit të saj përfundimtar".
- 2016d Ligji Nr. 34/2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për sigurimet shoqërore".
- 2016e Ligji Nr. 42/2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për sigurimet shoqërore".
- 2016f Ligji Nr. 121, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- 2016g Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020.
- 2017 Ligji Nr. 18, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- 2018a Ligji Nr. 16, "Për diasporën".
- 2018b Ligji Nr. 32, "Për fondin shqiptar për zhvillimin e diasporës".
- 2018c Strategjia kombëtare e diasporës dhe migracionit 2018–2024.
- 2019a Vendim Nr. 747, "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile".
- 2019b Ligji Nr. 45, "Për mbrojtjen civile".
- 2019c Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022.
- 2019d Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit.
- 2020a Ligji Nr. 113, "Për shtetësinë".
- 2020b Ligji Nr. 155, "Për ndryshimet klimatike".
- 2020c Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025 dhe Plani i Veprimit 2021–2022.
- 2020d Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet, 2021–2026 dhe Plani i saj i Veprimit 2021–2023.
- 2020e Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021–2025.
- 2021a Plani Rezerve për fluksin e mundshëm të migrantëve dhe azilkërkuesve në kufirin shqiptar. Nuk gjendet në internet.
- 2021b Ligji Nr. 10, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
- 2021c Ligji Nr. 31, "Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisëdhe bashkëpunimit ndërmjet republikës së shqipërisë, mbretërisë së bashkuar të britanisë së madhedhe irlandës së veriut".
- 2021d Ligji Nr. 79, "Për të huajt".
- 2021e Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
- 2021f Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2021–2030.

- 
- 2021g Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore, 2021–2030 dhe Plani i saj i Veprimit.
- 2021h Voluntary Review Report on the Status of Implementation of the Global Compact for Migration in Albania.
- 2022a Vendimi Nr. 169, “Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë”.
- 2022b Vendimi Nr. 173, “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e Task-Forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare”.
- 2022c Vendimi Nr. 174, “Për procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
- 2022d Ligji Nr. 23/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore”.
- 2022e *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin European 2030.*



ANEKS

## Procesi i MGI

**1****Nisja e procesit të MGI**

Hapi i parë i procesit është të shpjeguarit për zyrtarët kyç të qeverisë se çfarë nënkupton MGI, në mënyrë që të sigurohet kuptimi dhe mbështetja e plotë për projektin.

**2****Mbledhja e të dhënave**

Hapi i dytë i procesit është fillimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave, bazuar në rreth 90 tregues përgjatë gjashtë dimensioneve të MiGOF. Më pas hartohet një profil i qeverisjes së migracionit, bazuar në analizën e gjetjeve, i cili ndahet me partnerët nga qeveria.

**3****Konsultimi ndërministror**

Hapi i tretë i procesit është organizimi i një konsultimi ndërministror ku të gjitha ministritë dhe aktorët përkatës diskutojnë praktikën e mira dhe fushat kryesore që mund të zhvillohen më tej, të identifikuara në variantin paraprak të profilit të qeverisjes migratore, si edhe prioritetet për të ardhmen. Kjo është edhe një mundësi për ta që të komentojnë dhe të japin sugjerime për variantin paraprak të profilit.

**4****Publikimi i raportit në Portalin Global për të Dhënat Migratore**

Pasi profilet e qeverisjes së migracionit finalizohen dhe vlerësohen nga partnerët e qeverisë, ata publikohen në [Portalin Global për të Dhënat Migratore](#) dhe në [Platformën e IOM për Publikimet](#).





[www.migrationdataportal.org/mgi](http://www.migrationdataportal.org/mgi)

#migrationgovernance

 @IOM

 @UNmigration

 @UNmigration

 MGI@iom.int